



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 26 Prill 2023

Nr: 416

Ora: 12:00

VENDIM

PËR

ZGJATJEN E AFATIT TË DENONCIMIT TË Z. FLAMUR NOKA DEPUTET I KUVENDIT TË SHQIPËRISË NDAJ PARTISË SOCIALISTE TË SHQIPËRISË PËR SHKELJE ADMINISTRATIVE PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023

Në mbështetje të neneve 19, pika 1, shkronja “dh”, “f”, dhe “n” e pika 2 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe nenit 7, pika 3, e vendimit nr. 9, datë 9.4.2021, “Për procedurat e funksionimit dhe mirëmbajtjes së portalit, procedurat dhe afatet e hetimit administrativ të denoncimeve dhe vendimin që merret në përfundim të tyre”, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve

KONSTATOJ:

Neni 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n” e pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar përcakton kompetencat që ushtron Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.

Referuar nenit 7, të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010, “Për kundravajtjet administrative”, kompetenca për konstatimin e kundërvajtjes, me përjashtim të rasteve kur ligji parashikon ndryshe, i takon organit administrativ, përgjegjës për zbatimin e ligjit të posaçëm, titullarit të organit administrativ, që merret me zbatimin e ligjit, në rastet kur ligji nuk shprehet për kompetencën për shqyrtimin e kundërvajtjes dhe nxjerrjen e vendimit përkatës.

Bazuar në përcaktimet e nenit 7, të vendimit nr. 9, datë 9.4.2021, “Për procedurat e funksionimit dhe mirëmbajtjes së portalit, procedurat dhe afatet e hetimit administrativ të denoncimeve dhe vendimin që merret në përfundim të tyre” të Komisionit Rregullator, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve:

Data: 26 Prill 2023

Nr: 416
Ora: 12:00



“Për zgjatjen e afatit të denoncimit ndaj z. Flamur Noka, deputet i Kuvendit ndaj subjektit zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë”

- Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve fillon procedurën administrative dhe hetimin administrativ kryesisht me depozitim të denoncimit në Portalin e Denoncimeve ose kur ajo mbërrin drejtpërdrejtë në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.
- Afati që ka Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për shqyrtimin administrativ të denoncimit është jo më i gjatë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë nga paraqitja e tij.
- Afati i parashikuar në pikën 2, të këtij neni mund të zgjatet me vendim me shkrim të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, kur çështja është komplekse ose është e nevojshme kryerja e hetimeve administrative shtesë.

Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në datën 21.2.2023, është administruar shkresa me nr. 991 prot., nga z. Flamur Noka, Deputet i Kuvendit të Shqipërisë me Lëndë "Ankesë për lancimin dhe përdorimin e aplikacionit "Aktiv1sti" nga subjekti politik Partia Socialiste e Shqipërisë, nëpërmjet të cilit pretendohet se ka: *"Shkelje të detyrimit ligjor të parashikuar nga neni 92 i Kodit Zgjedhor dhe të vendimit nr. 9/2020 i Komisionit Rregullator, e kryer nga Partia Socialiste e Shqipërisë. Prej lancimit, bazuar në publikimet në media dhe në rrjetet sociale rezultojnë se rreth 70 mijë persona e kanë shkarkuar si aplikacion, nga një verifikim i shpejtë rezulton se shumica janë punonjës të administratës, pretendohet se janë të detyruar të rregjistrohen dhe të japin të dhenat e tyre personale"*.

Edhe pse ka përfunduar afati 60 (gjashtëdhjetë) ditor i shqyrtimit të këtij denoncimi, hetimi administrativ është ende i papërfunduar, për shkak të kompleksitetit të çështjes objekt shqyrtimi.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronja "dh", "f", dhe "n" e pika 2 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar dhe nenit 7, pika 3, e vendimit nr. 9, datë 9.4.2021, "Për procedurat e funksionimit dhe mirëmbajtjes së portalit, procedurat dhe afatet e hetimit administrativ të denoncimeve dhe vendimin që merret në përfundim të tyre" të Komisionit Rregullator, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve

V E N D O S:

1. Zgjatjen e afatit të shqyrtimit administrativ të denoncimit ndaj Partisë Socialiste të Shqipërisë.
2. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palës nëpërmjet postës elektronike.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

